

QEVERISJA VENDORE DHE PERFSHIRJA E KOMUNITETIT LGBTI



Ky dokument u prodhua si pjesë e inisiativave publike të pjesëmarrësve të “Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike” dhe u mbështet nga Akademia e Studimeve Politike. Ofrimi i ekspertizës profesionale të këtyre hulumtimeve ndaj politikëbërësve synon të sigurojë një platformë diskutimesh për shkëmbimin e ndërsjelltë të ideve të reja.

Përgatiti:

**Ersida Teliti
Arbër Kodra**

Hyrje

Respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut është një nga kushtet kryesore të shtetit të së drejtës. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë¹, si dhe akte të tjera kombëtare apo ndërkombëtrare, ku aderon shteti ynë afirmojnë parimin e barazisë së të gjithë personave.

Pavarësisht këtij kuadri ligjor, diskriminimi në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor është një çështje mbizotëruese në shoqërinë shqiptare. Komunitetet lezbike, homoseksuale, biseksuale, transgjinore dhe intersex (LGBTI) përballen me stigmën dhe diskriminimin e rëndë në nivel individual, familjar dhe në komunitet. Kjo kushtëzon qasjen e tyre në shëndetësi, arsim dhe shërbime sociale, si dhe në disa raste ndikon negativisht në arsimimin dhe mundësitë e tyre të punësimit. Mungesa e informatave dhe njohurive për të drejtat e personave LGBTI është një nga arsyt e rritjes së diskriminimit ndaj LGBTI në Shqipëri, si dhe frika nga stigmatizimi dhe mungesa e pranimit nga qarqet më të gjera të njësisë familjare².

Reagimet e fundit nga organizatat që punojnë për komunitetin LGBTI kanë ardhur pas fjalës së mbajtur nga ish-deputetja Mesila Doda në datë 7 Korrik 2016 në kohën kur Kuvendi i Shqipërisë po diskutonte në lidhje me ndryshimet kushtetuese, të cilat ndër të tjera përfshinin një mbrojtje më të gjerë nga diskriminimi për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Deputetja Doda pretendoi se këto ndryshime do t'i jepnim mundësi komunitetit LGBTI që të kërkonte barazi në martesë, që në fakt nuk është e vertetë.

Nuk është hera e parë që Kuvendit të Shqipërisë përdoret nga politikanët shqiptarë për të hedhur baltë apo kërcënuar publikisht komunitetin LGBTI. Përmendim këtu rastet e disa viteve me

¹ Neni 18, i njohur si neni klasik i barazisë parashikon: “1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.

2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si: gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.

3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive”.

² Sipas "NDI Poll për Çështjet LGBTI në Ballkan" 2015, të dhënat tregojnë se 61% e shqiptarëve thonë se nuk janë kundër njerëzve LGBTI, por personat LGBTI kanë frikë të tregojnë orientimin e tyre seksual jashtë shtëpive të tyre; 52% mendojnë se në një familje normale një fëmijë që tregon orientim homoseksual nuk pranohet; 48% mendojnë se homoseksualiteti është një sëmundje; 28% dëshiron që homoseksualiteti të dënohet; 32% mendojnë se njerëzit trans-gjinorë janë të angazhuar në aktivitetin e prostitucionit; dhe 24% mendojnë se është mjaft e drejtë të ndëshkohen homoseksualët. Këto të dhëna zbulojnë një "perceptim negativ" dhe shkallë të lartë të paragjykimeve kundër komunitetit LGBTI në Shqipëri. Anketa, zbulon nivele të ulëta të njohurive rreth grupeve që përbëjnë komunitetin LGBTI dhe një shkallë përkatëse të lartë të rezistencës ndaj dhënies së të drejtave dhe mundësive të barabarta bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor. Në të njëjtën kohë, të anketuarit në sondazh hedhin poshtë dhunën fizike kundër anëtarëve LGBTI të shoqërisë.

NDI Poll on LGBTI Issues in the Balkans”2015: www.ndi.org/LGBTI_Balkans_poll

rradhë për çështjet e ngritura nga organizatat LGBTI për përdorim gjuhe diskriminuese ndaj komunitetit si rastin e ish-deputetit Murat Basha për gjuhën diskriminuese gjate emisionit Opinion, rastin e deputetit Tritan Shehu, rastin e ish- Zëvendës Ministrorit Ekrem Spahiu për fyerjen dhe shkeljen e ligjit 105 të Kodit Penal etj. Organizatat shprehen se ka ardhur koha që çdo politikan të vendoset përpara përgjegjësisë ligjore dhe qytetare për fjalët dhe veprimet, të cilat shkelin të drejtat dhe barazinë e qytetarëve apo nxisin urrejtjen.

Deri në dhjetor 2016 ka pasur **532** raste të raportuara të dhunës psikologjike. Vetëm **5** nga këto raste janë raportuar tek autoritetet. Kjo ndodh kryesisht si pasojë e mungesës së besimit nga pjesëtarët e komunitetit në institucionet shtetërore dhe nga frika që mos kthehen në target diskriminimi nga vetë punonjësit e këtyre institucioneve si në rastin e Policisë së Shtetit. Në **5** nga rastet e raportuara anëtarët e komunitetit kanë hasur armiqësi nga oficerët e policisë. Ka pasur **47** raste të diskriminimit në vendet e punës dhe / ose diskriminim në rekrutim dhe përzgjedhje. Ka raste që personat LGBTI kanë vështirësi në gjetjen e punës për shkak të stigmës dhe paragjykit, duke përjetuar ngacmime seksuale në bazë të orientimit seksual gjatë intervistave të punës dhe duke u pushuar nga puna për shkak se punëdhënësi ka zbuluar orientimin seksual të punëmarrësit. Anëtarët e komunitetit LGBT që janë në marrëdhënie pune kanë raportuar se përjetojnë tallje, fyerje, ofendime nga kolegët në vendet e punës. Janë regjistruar **13** raste diskriminimi kur persona të komunitetit LGBTI i janë drejtuar shërbimit shëndetësor.

Për shkak të mungesës së pranimit brenda shoqërisë, në përgjithësi dhe familjes, në vecanti, të rinjtë LGBTI detyrohen të largohen nga shtëpia, duke mos marrë më mbështetje financiare nga to. Për shkak të mundësive të kufizuara të punësimit të ofruara për të rinjtë, shumë persona LGBTI mbështeten në bizneset familjare për të fituar jetesën. Kjo zgjidhje ekonomike shpesh rrezikohet kur familjet zbulojnë se fëmijët e tyre janë LGBTI.

Dhuna në familje mbetet problematike brenda komunitetit LGBTI. Raste të dhunës në familje janë shumë të shpeshta për anëtarët e komunitetit LGBTI. Në 2016, janë raportuar me mbi **12** raste të dhunës në familje, të gjitha rastet e raportuara kanë përjetuar dhunë psikologjike nga prindër që mendonin se fëmija e tyre mund të ishte gej ose lezbike. Shtatë (**7**) anëtarë të komunitetit LGBTI raportuan se përveç dhunës psikologjike i janë nënshtruar dhunës fizike nga familjaret e tyre kur këta të fundit kishin zbuluar se fëmijët e tyre kishin orientim seksual LGBTI.

Së fundmi, situata e përgjithshme e anëtarëve të komunitetit që raportojnë raste të dhunës tregon qartë se personat që përballen me diskriminim dhe dhunë në publik janë zakonisht meshkuj të moshës **17- 35**. Në shumicën e rasteve personat e komunitetit përballen me dhunë verbale, por dhuna fizike është gjithashtu e shpeshtë. Nga komuniteti i punonjësve të seksit raportohen pothuajse përditë raste dhune dhe kërcënimi. Në **70%** të rasteve dhuna dhe kërcënimi vjen nga banorët e zonës , 20% nga klientët e dhunshëm, dhe në **10%** te rasteve nga punonjësit e policisë

të cilët kërkencojnë, dhunojnë dhe ofendojnë punonjësit e seksit. Gjithashtu gjatë vitit 2016 kemi dokumentuar **17** raste të komunitetit LGBT **6**(Trans), **3** (lesbikë), **8** homoseksual që kanë parë largimin nga Shqipëria si një alternativë drejt punësimit dhe përmirësimit të kushteve të jetesës dhe pranimit nga shoqëria. **Tetë (8)** nga këto raste kanë statusin e azilkerkuesit në shtetet Francë, Suedi dhe Belgjike. Nëntë **(9)** raste e kanë vlerësuar emigrimin si një mundësi për të rritur të ardhurat dhe mbështur familjen.³

Sipas Raportit të hartuar nga Streha 2015-2016⁴, është rritur numri i individëve LGBTI (kryesisht të rinjve) që kërkojnë dokumentacion dhe ndihmë që të largohen nga Shqipëria dhe të kërkojnë azil jashtë shtetit. Rreth 38% nga komuniteti LGBTI në Shqipëri po planifikojnë të largohen nga vendi duke kërkuar një jetë të sigurt dhe më të mirë.

Në vitin 2015, Parlamenti Shqiptar miratoi rezolutën "Për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të personave që i përkasin komunitetit LGBTI në Shqipëri", ku parashikohet detyrimi i qeverisë shqiptare, për të miratuar një sërë aktesh me synim lehtësimin e kushteve të jetesës së njerëzve LGBTI. Një nga rekomandimet parashikonte miratimin e një plani kombëtar të veprimit LGBTI, programet e trajnimit të diversitetit për mësuesit dhe rritja e mbështetjes së Avokatit të Popullit dhe organizatave të shoqërisë civile.

Në maj 2016, qeveria shqiptare miratoi "Planin Kombëtar të Veprimit (PKV) për personat LGBTI 2016-2020"⁵. Plani përfshin një model ndryshimi i cili synon të krijojë një kulturë të përfshirjes dhe hapjes ndaj diversitetit dhe të kontribuojë më tej në forcimin e komunitetit LGBTI. PKV përbën dokumentin kryesor të politikës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të personave LGBTI në disa fusha, si: arsim, punësim, shëndetësi dhe strehim.

Plani konsiderohet nga organizatat hapi më i madh dhe më i suksesshëm i ndërmarrë nga qeveria shqiptare që nga miratimi i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", si dhe krijimi i një strukture të posaçme sic është Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Mungesa e ndërgjegjësimit, si dhe niveli shumë i ulët i njohjes së kuadrit ligjor kushtëzojnë qasjen e anëtarëve të këtij komuniteti me pjesën tjetër të shoqërisë.

Bazuar në situatën aktuale të personave LGBTI në Shqipëri, disa nga problemet kyçe për t'u adresuar përfshijnë si në vijim:

1. Mungesa e vetëdijes për të drejtat e personave LGBTI, -
2. Ka mungesë të ndërgjegjësimit në familje, komunitet dhe shoqëri për të drejtat e njerëzve LGBTI dhe si rezultat i kësaj është e nevojshme një ndërhyrje urgjente në rritjen e ndërgjegjësimit për të drejtat LGBTI. –

³ Raport me dokumentim rastesh dhe përshkrim të situatës për 2016, Aleanca kundër Diskriminimit LGBT, dhe Raport nga grupi i familjeve të personave LGBTI "JAM Fëmija YT!", Open Mind Spectrum Albania (OMSA).

⁴ Streha's annual report 2015-2016, http://strehaLGBTI.al/en_US/

⁵ Për më shumë referohu: http://www.sociale.gov.al/files/documents_files/PKV_LGBTI_2016-2020.pdf

3. Niveli i ulët i partneritetit midis OSHC-ve dhe institucioneve-
4. Mungesa e iniciativave të tilla janë zbatuar në baza ad-hock dhe është e nevojshme rritëzimi i përbashkët dhe partneritetin e institucioneve shtetërore, hartuesit e politikave dhe shoqërinë civile në përpjekjet kundër neglizhimit, stigmës dhe diskriminimit të personave LGBTI. –
5. Nevojat për shërbime cilësore për personat LGBTI –
6. Bashkëpunimi midis shoqërisë civile dhe organizatave të qeverisjes vendore ao qendrore do të lehtësojë në përmbushjen e këtij problemi. –
7. Kapacitetet joadekuate të OSHC-ve në nivel kombëtar për ndërmarrjen e veprimeve që kanë të bëjnë me të drejtat LGBTI-OSHC-të që punojnë në çështjet LGBTI kanë burime të kufizuara financiare dhe njerëzore dhe kapacitete të pamjaftueshme organizative dhe menaxhuese për të ndërmarrë veprime që përmirësojnë situatën e personave LGBTI.

Kapitulli I

Metodologjia

1.1. Qëllimi dhe objektivat

Ky punim synon të ofrojë një pasqyrim të realitetit shqiptar në lidhje me aspekte të kompetencave dhe mundësisë efektive të ushtrimit të tyre, në kuadër të qeverisjes vendore. Përtej hapësirave dhe kufijve që vendos ligji janë institucionet ato, nëpërmjet burimeve njerëzore, të zgjedhur apo të emëruar që vendosin mënyrën e mbështetjes apo përkrahjes së anëtarëve të komunitetit LGBTI. Një qasje dhe sjellje pozitive ndaj tyre reflekton një hapje të të gjithë sistemit, duke lehtësuar pranimin për to, për familjarët e tyre dhe shoqërinë në tërësi. Një nga parimet e mirëqeverisjes, sipas Këshillit të Europës⁶, si dhe sipas OKB⁷, është pjesëmarrja dhe përfshirja, pa asnjë lloj arsyeje diskriminimi.

Qëllimi kryesor i këtij punimi është vënia në dukje e përfshirjes dhe mbështetjes së komunitetit LGBTI, si një aspekt i vecantë i sistemit të mirëqeverisjes në qeverisjen vendore.

Realizimi i këtij punimi përbën një sfidë për shoqërinë shqiptare mbështetur në metodologjinë e ndjekur. Objektivat e këtij punimi mund të jenë të shumtë, por të strukturuar si më poshtë:

Objektivi 1. *Analizimi I kompetencave të bashkive në kuadër të reformës territoriale (qasje ligjore) në lidhje me komunitetin LGBTI.*

⁶ Parimi i 11-të: Të drejtat e njeriut, diversiteti kulturor dhe përfshirja sociale. Për më shumë:

[https://www.coe.int/en/web/good-governance/12-principles-and-elope#{"25565951":10}](https://www.coe.int/en/web/good-governance/12-principles-and-elope#{)

⁷ Për më tepër:

http://www.undp.org/content/dam/undp/library/Poverty%20Reduction/Inclusive%20development/Towards%20Human%20Resilience/Towards_SustainingMDGProgress_Ch8.pdf

Objektivi 2. *Rritja e nivelit të ndërgjegjësimit të bashkive për përfshirjen e komunitetit LGBTI (qasje krahasimore)si dhe gjetja e instrumentave për sigurimin e përfshirjes dhe respektimit të të drejtave të këtij komuniteti.*

1.2 **Metodologjia e përdorur**

Në funksion të arritjes së qëllimit dhe objektivave të këtij punimi janë përdorur metodat cilësore dhe metoda sasiore, ndonëse të kufizuara.

Target grupi i cili është marrë në studim janë bashkitë e reja, ndonëse të kufizuara në numër vetëm 3 – përkatësisht Bashkitë Tiranë, Shkodër dhe Vlorë. Përzgjedhja e tyre është rastësore, duke ndjekur modelin e bashkive më të mëdha dhe aktive, në veri dhe jug, si dhe bashkinë Tiranë.

Në metodat cilësore të përdorura janë:

- Përcaktimi i fushës së studimit, qëllimit dhe objektivave;
- Rishikimi dhe hulumtimi i literaturës;
- Analizë e kuadrit ligjor;

Në metodat sasiore të përdorura (të kufizuara)

- Metoda krahasimore.

Ndërthurja e këtyre metodave, sëbashku me kufizimet synon të realizojë në mënyrë sa më të plotë qëllimin dhe objektivat e këtij studimi.

Kapitulli 2

Kuadri ligjor

2.1 Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"

Me synim rregullimin në mënyrë sa më të plotë kompetencat midis njësive të qeverisjes vendore, Kuvendi miratoi ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Në kuptim të këtij ligji, “Autonomi vendore” është e drejta dhe aftësia e njësive të vetëqeverisjes vendore, të krijuara sipas Kushtetutës dhe këtij ligji dhe në kuadër të kufizimeve të tij, që të rregullojnë dhe të administrojnë një pjesë thelbësore të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të bashkësisë. Pra njësia e vetëqeverisjes vendore ka të drejtën të administrojë të gjitha çështjet publike dhe në interes të bashkësisë. Gjithëpërfshirja e komunitetit LGBTI është pjesë e kësaj autonomie.

Ligji për vetëqeverisjen vendore, duke u mbështetur edhe në një nga parimet e mirëqeverisjes, parimin e subsidiaritetit⁸, parashikon në nenin 3 të tij, si pjesë e misionit të qeverisjes vendore, ndër të tjera edhe: "...a) njohjen e ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive; b) respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;... d) realizimin e shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë; dh) nxitjen efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore..."

Ligjvënësi është kujdesur të përfshijë brenda misionit parimin e barazisë, përmbushjen dhe realizimin e shërbimeve pa asnjë lloj diskriminimi, gjithëpërfshirjen⁹ dhe pjesëmarrjen¹⁰ si elemente kyç të mirëqeverisjes.

Neni 8/ paragrafi 1 i këtij ligji parashikon: "Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore mund të ndërmarrin nisma me interes publik vendor në territorin e juridiksionit të tyre për çdo çështje që nuk u ndalohe me ligj ose që nuk i është dhënë ekskluzivisht me ligj një organi tjetër shtetëror". Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore mund të ndërmarrin nisma me interes publik vendor, përfshirë dhe nisma të tilla si: ndërgjegjësimi apo bashkëpunimi me OJF të komunitetit LGBTI.

Ligji në nenet 10 e vijues parashikojnë dhe lënë të hapur mundësitë e bashkëpunimit të njësive të vetëqeverisjes vendore me qeverisjen qendrore në funksion të përmbushjes së kompetencave të tyre dhe zgjidhjes së problemeve të përbashkëta. Pavarsisht zhvillimeve në nivel qendror nuk ka ndonjë shembull pozitiv bashkëpunimi ose konsultimi midis këtyre qeverisjeve për çështje që prekin ose çenojnë komunitetin LGBTI, ku të ngrihet zëri dhe të bëhet publike dhe e ndjeshme mbështetja dhe çështja për të cilën ka mbështetje¹¹.

⁸ "Subsidiaritet" është parimi i kryerjes së funksioneve dhe ushtrimit të kompetencave në një nivel qeverisjeje sa më pranë komunitetit, duke pasur parasysh rëndësinë dhe natyrën e detyrës, si dhe kërkesat e efijencës e të ekonomisë.

Ligji nr. 8652, datë 31.07.2010 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" përcakton se:

"Subsidiaritet" është parimi i kryerjes së funksioneve dhe ushtrimit të kompetencave në një nivel qeverisjeje sa më pranë shtetasve.

Në të dy ligjet, parimi i subsidiaritetit qëndron në themel të mirëqeverisjes në nivel vendor, duke realizuar afrimin me komunitetin, por ligji i ri merr në konsideratë aspekte ekonomike dhe kosto oportune në përmbushje të kompetencave.

⁹ Barazia dhe përfshirja është një tjetër parim i mirëqeverisjes sipas së cilit: "Organizata që ofron mundësinë që palët e interesuara të mbajnë, rrisin ose në përgjithësi përmirësojnë mirëqenien e tyre, siguron mesazhin më bindës në lidhje me arsyet e ekzistencës dhe vlerën e shoqërisë".

¹⁰ Pjesëmarrja, si parim i mirëqeverisjes nënkupton: Pjesëmarrja nga burrat dhe gratë, qoftë drejtpërdrejt ose nëpërmjet përfaqësuesve legjitimë, është një gur themeli kryesor i qeverisjes së mirë. Pjesëmarrja duhet të jetë e informuar dhe e organizuar, duke përfshirë lirinë e shprehjes dhe shqetësimin e madh për interesat në të mirë të organizatës dhe shoqërisë në përgjithësi.

<http://www.unescap.org/resources/what-good-governance>

¹¹ Qeveritë shqiptare janë përpjekur të mbështesin komunitetin LGBTI, por në mënyrë indirekt dhe të fshehur, në një gjuhë më specifike do të thonim, Offline. Arsyja kryesore ka qenë dhe është humbja e votave. Në kuadër të bashkëpunimeve janë tentuar të krijohen lehtësira për OJF, por s'ka asgjë konkrete, rritje ndërgjegjësimi apo mbështetje të hapur.

Kreu VI i këtij ligji afirmon më tej 3 aspekte të rëndësishme të mirëqeverisjes si: transparenca¹², konsultimi dhe pjesëmarrja qytetare¹³. Po sa zbatohen këto në rastin e komunitetit LGBTI? Një pyetje e cila do të marrë përgjigje përgjatë gjithë trajtimit të këtij punimi.

Në kuadër të detyrimeve të njëjësive të qeverisjes vendore për konsultim publik, neni 16 i këtij ligji parashikon se: “1. Organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes. 2. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë koordinatorin për njoftimin dhe konsultimin publik, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për njoftimin dhe konsultimin publik.”

Problemet dhe çështjet që prekin komunitetin LGBTI janë ende shumë të ndjeshme. Përfshirja e tyre në vendimmarrje do të mund të lehtësonte pozitën e tyre në shoqëri, si dhe nivelin e etiketimit dhe stigmatizimit.

Ligji shkon dhe më tej në përcaktimet për pjesëmarrje, ku kategoria e përfshirë është bashkësia. Neni 18 i tij përcakton se: “2. Këshillimi me publikun, në çdo rast, bëhet sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit, duke përdorur një nga format e nevojshme, si takimet e hapura me banorët e grupet e interesit, takime me specialistë, me institucione të interesuara dhe organizata jofitimprurëse ose nëpërmjet marrjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore. 3. Aktet e këshillit publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe afishohen në vende publike, të caktuara nga këshilli me akses të lirë publik, brenda territorit të njësisë vendore dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Informimi i publikut në çdo bashki bëhet në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkatës për këtë qëllim.”

Në një interpretim literal të këtij neni, këshillimi përfshin këshillimin me individë pjesë e komunitetit LGBTI, shumë anëtarë të këtij komuniteti apo OJF që kanë në fokus këtë komunitet.

Ky ligj i njeh grupeve të interesit të drejtën për kërkesë, ankesë, vërejtje, si dhe të drejtën për iniciativë qytetare¹⁴. Nga informacionet e marra në rrugë jozyrtare nuk kemi shembuj pozitiv të

¹² Parimi i 4-rt i parashikuar nga Këshilli i Europës është hapja dhe transparenca, sipas së cilit: Vendimet merren dhe zbatohen në përputhje me rregullat dhe rregulloret. Ka qasje në publik për të gjitha informatat të cilat nuk janë të klasifikuara për arsye të përcaktuara siç parashikohet me ligj (si për shembull mbrojtja e privatësisë ose sigurimi i drejtësisë së procedurave të prokurimit). Informacioni mbi vendimet, zbatimin i politikave dhe rezultateve është vënë në dispozicion të publikut në mënyrë të tillë që të mundësojë që ai të ndjekë dhe të kontribuojë në mënyrë efektive në punën e autoritetit lokal.

[https://www.coe.int/en/web/good-governance/12-principles-and-elope#{"25565951":3}](https://www.coe.int/en/web/good-governance/12-principles-and-elope#{)

¹³ Po aty, parimi i parë i parashikuar është: Kryerja e drejtë e zgjedhjeve, përfaqësimi dhe pjesëmarrja, sipas të cilit qytetarët janë në qendër të veprimtarisë publike dhe janë të përfshirë në mënyra të përcaktuara qartë në jetën publike në nivel lokal. Të gjithë burrat dhe gratë mund të kenë një zë në vendimmarrje, qoftë drejtpërdrejt ose nëpërmjet organeve legjitime të ndërmjetme që përfaqësojnë interesat e tyre. Pjesëmarrja e tillë e gjerë ndërtohet mbi liritë e shprehjes, asamblesë dhe asociacionit. Të gjitha zërat, duke përfshirë ato të më pak të privileguara dhe më të rrezikuara, dëgjohen dhe merren parasysh gjatë marrjes së vendimeve, duke përfshirë edhe alokimin e burimeve.

¹⁴ Neni 19 parashikon: “1. Çdo qytetar apo grupe që përfaqësojnë komunitetet kanë të drejtë t’u drejtojnë kërkesa, ankesa apo vërejtje organeve të vetëqeverisjes vendore për çështje që lidhen me funksione dhe kompetenca në juridiksionin e njësisë së

iniciativave të komunitetit LGBTI, familjarëve të tyre për të filluar marrjen e ndonjë vendimi për mbrojtjen apo mbështetje të drejtave apo interesave të tyre. Iniciativat kanë qënë vetëm nga organizatat që punojnë për të drejtat e komunitetit LGBTI, për: bashkëpunim, rritje ndërgjegjësimit, ngritjen e zërit në qeveri, për ndryshimin e realitetit të jetës së personave LGBTI në Shqipëri. Përmendim këtu Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Planin Kombëtar të Veprimit, që edhe pse I miratuar me urdhër të Kryeministrit, asgjë nuk është bërë në bazë të planit të caktuar për implementimin e tij.

Neni 24 parashikon funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale, por nuk ka referenca specifike për kryerjen e funksioneve të caktuara në mbështetje të komunitetit LGBTI. ashkitë janë përgjegjëse për kryerjen dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. Ato kanë në kompetencë ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social dhe qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore. Ndonëse lista është e hapur, jo e mbyllur, në kategorinë e personave që marrin shërbime sociale, vlerësojmë se në një interpretim të zgjeruar përfshihet dhe nuk mund të përjashtohet komuniteti LGBTI.

Neni 28 shkon dhe më tej, ku parashikon: “6.Dhënien e granteve financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël e të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi, duke garantuar akses të balancuar gjinor”. Ky nen është mbështetur në parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, duke përfshirë dhe anëtarët e komunitetit LGBTI.

Një nga funksionet e bashkive në fushën e sigurisë publike është garantimi i mbarëvajtjes së marrëdhënieve në komunitet, parandalimi dhe ndërmjetësimi për zgjidhjen e konflikteve në komunitet. Pra, përtej ofrimit dhe dhënies së shërbimeve të ndryshme, njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të synojnë të parandalojnë konfliktet midis këtij komuniteti dhe bashkësisë në tërësi. Ndonëse afirmuar qartë dhe në mënyrë eksplicite në ligj nuk ka ndonjë shembull pozitiv ku njësi e vetëqeverisjes vendore të përmbushë këtë funksion .

Neni 32/ paragrafi 1 parashikon: “1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbime publike, në përputhje me funksionet e caktuara me ligj, duke përdorur instrumente të përshtatshme për të siguruar aksesin, cilësinë, sasinë dhe koston e përbalueshme nga të gjithë.” Ky nen paraqet qartazi ofrimin e shërbimeve pa asnjë lloj diskriminimi.

vetëqeverisjes vendore. 2. Organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara t'i marrin në shqyrtim kërkesat, ankesat apo vërejtjet dhe të kthejnë përgjigje brenda afateve të përcaktuara me ligj.”

Dhe në nenin 20 parashikohet se: “1. Çdo komunitet, nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar të tij, ose jo më pak se një për qind e banorëve të bashkisë ka të drejtë të paraqesin për vendimarrje në këshillin bashkiak iniciativa qytetare për çështje që janë brenda juridiksionit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Mënyra dhe forma e paraqitjes së këtyre iniciativave, procedura e shqyrtimit dhe miratimit të tyre përcaktohet në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të këshillit bashkiak. 2. Propozimet e ardhura në këshill si iniciativë qytetare, kur kanë ndikim financiar në buxhetin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, shqyrtohen në këshill, sipas rendit të ditës, dhe nuk mund të miratohen pa marrë më parë mendimin e kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore”.

Përfshirja e cdo strukture apo OJF që e mbështetin ate rrjedh nga neni 33 ku njësitë e vetëqeverisjes vendore sigurojnë dhënien e shërbimeve publike, nëpërmjet instrumenteve të tillë si: njësitë organizative të veta; ndërmarrjeve për shërbimet publike; dhënia e shërbimeve me palë të treta; partneriteti publik dhe privat; apo shoqëri tregtare në pronësi apo bashkëpronësi të njësisë vendore¹⁵.

2.2 Ligji 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”

Ky ligj është një aktet kryesore që synon të rrisë transparencën dhe gjithëpërfshirjen në vendimmarrje në kudër të njësitë të qeverisjes qendrore dhe vendore. Ai përcakton rregullat procedurale që duhen zbatuar për të garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset politikbërëse dhe vendimmarrëse nga organet publike. Qëllimi i këtij ligji është përfshirja e të gjithë aktorëve dhe subjekteve që kanë interes ose preken nga projektligje të ndryshme, dokumente strategjike kombëtarë dhe vendore apo politika me interes të lartë publik. Që në objekt ligji ngarkon me përgjegjësi dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Ligji qartëson edhe përkufizimin e “Grupit të interesit” duke përshkruar si të tillë, çdo organizatë jofitimprurëse që përfaqëson interesat e një grupi personash fizikë ose juridikë, si dhe subjekte të tjera të prekura apo të interesuara për projektaktet që i nënshtrohen procesit të konsultimit publik. Sipas këtij ligji do të kuptohet me “Konsultim publik”, tërheqja e mendimeve dhe sugjerimeve të palëve të interesuara për përmbajtjen dhe përmirësimin e projektaktit, nga momenti i publikimit të projektaktit deri në miratimin përfundimtar të tij.

Pra, procesi i konsultimit publik nënkupton realizimin e tij me efektivitet, që do të thotë marrje e mendimeve dhe e sugjerimeve, pasqyrimi ose jo i tyre dhe sqarimi në rast mospërfshirje të ndryshimeve. Kjo nënkupton që në cdo rast qe njesite e veteqeverisjes vendore miratojnë programe ose akte administrative që lidhen me çështje që prekin komunitetin LGBTI duhet të realizojnë këtë proces dhe të vleresojnë propozimet e bera nga individë ose OJF-te.

Neni 5 i ligjit parashikon: “Parimet në procesin e njoftimit e të konsultimit publik Procesit i njoftimit dhe i konsultimit publik kryhet në bazë të parimeve të mëposhtme: a) transparenca gjatë procesit të njoftimit e të konsultimit publik me pjesëmarrje gjithëpërfshirëse dhe jodiskriminuese; b) efektshmëria e procesit të vendimmarrjes në organet publike; c) përgjegjësia e organeve publike ndaj palëve të interesuara”. Ky nen parashikon dhe liston disa nga parimet e mirëqeverisjes si: transparenca, gjithëpërfshirja dhe mosdiskriminimi (barazia), efektiviteti dhe përgjegjësia. Komuniteti LGBTI nëpërmjet individeve ose OJF-ve që i perfaqesojne duhet të njoftohet për të qenë pjesë e konsultimit publik.

¹⁵ Informacioni dhe shembujt e bashkive shprehin qartë parashikime ligjore të mbetura në letër dhe të pazbatueshme.

Në nenet 6 e vijues të ligjit, parashikohet procedura e kryerjes së konsultimit publik, si dhe afatet përkatëse, duke siguruar kohë të mjaftueshme për palët e interesit për t'u njohur dhe për të ndikuar në procesin e vendimmarrjes së organeve publike.

Neni 8 i ligjit përcakton si palë të interesuara, përveç organeve publike dhe shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe grupet e interesit. Ky përcaktim është logjike e nenit 5. Për çështjet që janë ngushtësisht të lidhura me komunitetin LGBTI, vecanërisht në kuader të qeverisjes vendore (e cilesuar si qeverisja me prane qytetareve) ky komunitet ka të drejte të propozojë hartimin dhe miratimin e projekt-akteve sipas planit vjetor të vendimmarrjes. Në kuadër të qeverisjes qendrore rezultati kryesor është ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si nevojë dhe kërkesë e shoqërisë civile. Kjo shpreh qartë faktin se aksesit në qeverisjen vendore është shumë më i vogël dhe në astin e komunitetit LGBTI thuajse i papërfillshëm.

Në përputhje me parimin e transparencës dhe gjithëpërfshirjes, njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të marrin informacione dhe/ose opinione paraprake, vecanërisht nga ky komunitet, përpara hartimit të aktit.

Procesi i konsultimit publik nuk do të kishte efektivitet nëse nuk do të realizohet procedura e shqyrtimit të komenteve dhe rekomandimeve. Ligji ngarkon dhe njesite e vetëqeverisjes vendore të pasqyrojnë rekomandimet e pranuar dhe nje përmbledhje të arsyeve për mospranim. Kjo procedure rrit nivelin e besimit dhe të gjithëpërfshirjes jo vetëm të komunitetit LGBTI, por dhe të gjithë bashkësisë.

Një tjetër garanci ligjore, që stimulon pjesëmarrjen e komunitetit LGBTI në këto proces është dhe procedura që ka parashikuar legjislacioni për shqyrtimin e ankesave dhe përfshirja e Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Kapitulli III

Njësitë e vetëqeverisjes vendore. Shembuj konkretë

Studimet¹⁶ tregojnë se ndonëse ka gjetje pozitive në drejtim të qendrimeve përkundrejt komunitetit LGBTI, përsëri ka një nivel të lartë paragjykimesh, mos-pranimi apo refuzimi për barazinë midis personave LGBTI dhe atyre heteroseksualë.

Qëndrimet negative përkundrejt personave LGBTI ndikojnë drejtpërsëdrejti në cilësinë e ofrimit të shërbimeve në nivel vendor. Shkaku kryesor i këtyre qëndrimeve është i lidhur si me mungesën e kontakteve direkte me komunitetin LGBTI, mungesën e informacionit si dhe të trajnimeve në fushë. Mungesa e politikave, kodeve të sjelljes apo standarteve bazë të punës me minoritetet në çdo bashki rrit mundësinë e përforsimit të qendrimeve negative, në vend që ato me

¹⁶ Poni & Hazizaj (2016a) Community Services and the LGBT people community in Albania: *Public administration attitudes on LGBT people as service users, in 6 regions*. Tirana: Pink Embassy Publications, accessed 4.9.2016, <http://www.pinkembassy.al/sites/default/files/uploade/SHE%CC%88RBIMET%20VENDORE%20DHE%20KOMUNITETI%20LGBT%20NE%20SHQIPERI%202016.pdf>

kalimin e kohës të eleminohen tërësisht. Refuzimi i shërbimit, dhuna verbale dhe fizike, apo ngritja e shërbimeve të veçanta për personat LGBTI janë tregues se mungesa e standarteve të komunikimit dhe supervizimit të ofrimit të shërbimeve i detyron një pjesë të vogël të zyrtarëve publikë të jenë përjashtues, ndëshkues dhe diskriminues ndaj personave LGBTI.

Në një gjykim më personal, ky lloj përjashtimi dhe diskriminimi nuk iu jep mundësi personave LGBTI që të arrijnë të zhvillojnë potencialin e tyre njerëzor dhe si pasojë edhe kontributi i tyre në shoqëri nuk do të jetë i konsiderueshëm. Shoqëria ka tendencën që vetëm të humbasë zhvillimin që vjen kur të gjithë individët kanë mundësinë që të japin maksimumin e tyre në terma të zhvillimit human, kulturor, ekonomik etj.

3.1 Shembuj konkretë të bashkive

Me synimin për të përmbushur qëllimin dhe objektivat e këtij punimi, si dhe duke shfrytëzuar mjetet që na garanton ligji shqiptar, u janë drejtuar kërkesa për informacion tre Bashkive kryesore, përkatësisht Bashkisë Tiranë, Shkodër dhe Vlorë.

Këtyre Bashki u është kërkuar i njëjti informacion, në mënyrë që qasja dhe krahasimi të jetë sa më real.

Bashkive u është kërkuar ky informacion:

1. A ka pasur Bashkia që ju drejtoni projekte sociale të mbështetura nga ju?
Ju lutem kërkojmë të informohemi në lidhje me:
 - a. Numrin e projekteve.
 - b. Vitet e projekteve.
 - c. Qëllimin kryesor.
 - d. Nëse keni mundësi, Ju lutemi bashkëngjisni një kopje të dokumentave që e vërtetojnë realizimin e këtyre projekteve, raportet përkatëse etj.
2. A ka mbështetur Bashkia që ju drejtoni, projekte në bashkëpunim me organizatat e komunitetit LGBTI në vend?
Ju lutem kërkojmë të informohemi në lidhje me:
 - e. Organizatën që keni bashkëpunuar.
 - f. Numrin e projekteve.
 - g. Vitet e projekteve.
 - h. Qëllimin kryesor.
 - i. Rezultatin.
 - j. Nëse keni mundësi, Ju lutemi bashkëngjisni një kopje të dokumentave që e vërtetojnë realizimin e këtyre projekteve, raportet përkatëse etj.
3. A ka mbështetur Bashkia juaj projekte të shoqërisë civile, me target kryesor komunitetin LGBTI, financiarisht apo dhe me burime njerëzore?
Ju lutem kërkojmë të informohemi në lidhje me:

-
- k. Organizatën që keni bashkëpunuar.
- l. Numrin e projekteve.
- m. Vitet e projekteve.
- n. Qëllimin kryesor.
- o. Rezultatin.
- p. Nëse keni mundësi, Ju lutemi bashkëngjisni një kopje të dokumentave që e vërtetojnë realizimin e këtyre projekteve, raportet përkatëse etj.
4. A është pjesë e programit social të hartuar nga Bashkia juaj, mbështetja e komunitetit LGBTI, si pjesë e perspektivës së respektimit të të drejtave të njeriut?
Ju lutem kërkojmë të informohemi në lidhje me:
- q. Programin e bashkisë tuaj apo
- r. Planin strategjik.
- s. Nëse keni mundësi, Ju lutemi bashkëngjisni një kopje të tyre.
5. A keni në Bashkinë tuaj të punësuar anëtarë të komunitetit LGBTI, të deklaruar ose jo?
- t. Nëse po, sa është numri i tyre.
- u. A keni ndonjë politikë në favor të punësimit të komunitetit LGBTI?
- Nëse keni mundësi, Ju lutemi bashkëngjisni një kopje të tyre.

Aspekti pozitiv është korrektësia dhe përmbushja e detyrimit për informacion nga të tre Bashkitë, duke mundësuar krahasimin.

Në lidhje me informacionin që kemi kërkuar na rezulton se në të treja këto bashki vihet re një frymë pozitive për të bashkëpunuar me komunitetin LGBTI, po nuk ka veprime konkrete apo ndërmarrje të hapave ligjorë, cdo gjë është mbi bazë idesh apo projektesh.

Bashkitë Tiranë, Shkodër dhe Vlorë nuk kanë ende një plan social gjithëpërfshirës që të përfshijë dhe komunitetin LGBTI, si pjesë e perspektivës së respektimit të të drejtave të njeriut. Janë në procesin e hartimit të planeve. Pyetja që shtrohet në këtë rast është a do të realizohen këto plane apo do të mbeten në letër?

Bashkia Vlorë pranon se: "... do të hartojë e planifikojë në planin social mbështetjen e të gjithë target grupeve e sigurisht edhe për komunitetin e LGBTI për buxhetin e viti 2018".

Bashkia Shkodër pohon: "Ajo është në fazën përfundimtare të punës për finalizimin dhe miratimin e Planit Social."

Bashkia Tiranë është shprehur kështu: "Mbështetja e komunitetit LGBTI është pjesë e Draftit të Planit Social të Veprimit dhe Draftit të Planit të Përfshirjes Sociale në të cilat parashikohet:

- Zhvillimi i shërbimeve sociale për komunitetin LGBTI.

-
- Aktivitete ndërgjegjësuese që synojnë reduktimin e praktikave diskriminuese për personat LGBTI, përfshi bulizmin, - në shkollat e mesme te qytetit.
 - Aktivitete informuese që synojnë reduktimin e praktikave diskriminuese për personat LGBTI dhe ofrimin e shërbimeve miqësore ndaj tyre me punonjësit e administratës vendore që kane kontakt direkt me qytetarët – në Bashki, NJA, QMK të Bashkisë.
 - Prodhimi dhe shpërndarja e një pakete informuese mbi shërbimet miqësore ndaj komunitetit LGBTI.”

Sikurse konstatohet nga përgjigjet e tre bashkive, deri më tani, mbështetja, përfshirja dhe transparenca me komunitetin LGBTI ka mbetur thjesht në letra. Mbetet për t’u parë nëse këto përgjigje do të jenë reale dhe efektive pas miratimit të buxheteve të njësisë të vetëqeverisjes vendore për vitin 2018.

Gjithashtu, bashkitë e targetuara kanë marrëveshje bashkëpunimi me organizata të ndryshme që mbrojnë të drejtat dhe liritë themelore të komunitetit LGBTI, që do të thotë organizatat jofitimprurëse i janë drejtuar bashkive për bashkëpunim. Kjo shpreh një qëndrim pozitiv të tyre për të qenë të hapur dhe gjithëpërfshirës.

Kështu, Bashkia Vlorë citon bashkëpunimin me Shtëpinë e të Drejtave të Njeriut, si dhe Ambasadën PINK.

Bashkia e Shkodrës liston marrëveshjen e bashkëpunimit me organizatën Ambasada PINK. Bashkia Tiranë dhe Ambasada PINK në vitin 2015 kanë nënshkruar Letër Mirëkuptimi për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta dhe lehtësimin e proceseve teknike që synojnë përmirësimin e cilësisë së jetës së personave LGBTI në mjediset shoqërore dhe publike ku ata janë të pranishëm në nivel lokal dhe kombëtar.

Gjithashtu, Bashkia Tiranë ka mbështetur çdo vit Festalet e Diversitetit duke vënë në dispozicion ambjentet e kërkuara dhe lejet përkatëse për zhvillimin e aktiviteteve, po ashtu dhe për ngritjen e flamurit LGBTI për të përkujtuar Ditën Ndërkombëtare kundër Homofobisë, Bifobisë dhe Transfobisë.

Por a kanë qenë këto marrëveshje reale dhe të zbatueshme apo kanë mbetur në letër?

Në bashkitë përkatëse nuk ka persona të hapur, që i përkasin komunitetit LGBTI, ta cilët janë të punësuar në këto bashki.

Bashkitë treguan që janë të hapura për bashkëpunime dhe një pjesë e tyre shfaqen interes për trajnime të vazhdueshme për stafin e tyre. Në mënyrë indirekte, zyrtarët e këtyrë bashkive pranuan se ka një nivel të lartë paragjykimesh, mos-pranimi apo refuzimi për barazinë midis personave LGBTI dhe atyre heteroseksualë. Zyrtarët publikë të qeverisjes vendore mendojnë se personat LGBTI janë më inferiorë se pjesa tjetër e qytetarëve; nuk duhet të punësohen në administratën publike; nuk janë qytetarë si gjithë të tjerët dhe mendojnë se personat LGBTI duhet të kenë më pak të drejta se të tjerët. Të gjitha këto mendime dhe perceptime sigurisht që e japin impaktin e tyre negativ në drejtim ose të refuzimit të shërbimeve ose mos-dhënies së

shërbimeve të duhura përkundrejt çdo personi LGBTI, që rrjedhimisht shkakton si pasojë diskriminim dhe përjashtim social të mëtejshëm të tyre. Në këtë mënyrë njësitë e qeverisjes vendore nuk përmbushin parimet ku mbështetet mirëqeverisja, duke i cënuar drejtpërdrejtë ato. Pavarësisht se nuk janë studiuar pasojat që ka patur refuzimi i shërbimeve apo dhuna ndaj personave LGBTI, ajo çka mund të thuhet është se qendrime të tilla vetëm përforcojnë sjelljet negative ndaj personave LGBTI dhe rrjedhimisht edhe përjashtimin e tyre të mëtejshëm social, në kundërshtim të plotë me politikën shtetërore, legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar ku aderohet shteti shqiptar.

Bashkitë kanë si synime të tyre për të ardhmen:

- Bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile për të avancuar në repsketimin e të drejtave të njeriut në nivel vendor për të rritur pranimin e personave LGBTI në shoqëri dhe angazhimi i saj për të zhvilluar aktivitetet konkrete që kontribuojnë për përfshirjen e këtij komuniteti në jetën sociale të bashkësisë.
- Angazhimi i Bashkisë për të punuar drejt një plani masash që kanë të bëjnë me: uljen e gjuhës së diskriminimit dhe urrejtjes, rritjen së pranimit në shoqëri, mbrojtjes nga bulizmi dhe diskriminimi në shkollë, mbrojtjes në mjedisin e punës dhe atë familjar etj (meqë personat LGBTI bien pre e keqtrajtimit brenda familjes së tyre dhe shpesh problemet në familje ndikojnë në mirëqenien e tyre fizike dhe emocionale).

Prioritetet e këtyre Bashkie në të ardhmen duhet të jenë për të gjithë njësitë e vetëqeverisjes vendore. Përtej aspektit social, këto struktura do të përmbushin detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, si dhe do të jenë të drejtuar drejt mirëqeverisjes, duke ofruar gjithëpërfshirje, transparencë, barazi dhe respektim të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si pjesë e shtetit të së drejtës.

Konkluzione

- Kuadri ligjor shqiptar është në përputhje të plotë/pjesshme me frymën e përgjithshme të akteve kombëtare dhe ndërkombëtare për respektimi e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.
- Të drejtat e komunitetit LGBTI janë të drejta dhe liri themelore, si qenie njerëzore.
- Lgji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” rregullojnë të drejtën dhe aftësinë e njësitë të vetëqeverisjes vendore, të krijuara sipas Kushtetutës dhe këtij ligji dhe në kuadër të kufizimeve të tij, që të rregullojnë dhe të administrojnë një pjesë thelbësore të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të bashkësisë.
- Fryma e këtij ligji është ofrimi dhe dhënia e shërbimeve sociale apo të tjera, të gjithë anëtarëve të komunitetit pa asnjë lloj diskriminimi, duke i ftuar ato në vendimmarrje.

-
- Në realitetin nuk ndjehet asnjë frymë e tij për anëtarët e komunitetit LGBTI, duke cënuar parime të tilla të mirëqeverisjes, si: shteti i së drejtës, gjithëpërfshirja, parimi i barazisë etj.
 - Komuniteti LGBTI është një nga grupet e interesit, që duhet të jetë pjesë e konsultimit publik për çështje që i prekin direkt ose indirekt.
 - Pas përgjigjes së kërkesës për informacion, në tre njësi të vetëqeverisjes vendore: Tiranë, Shkodër dhe Vlorë rezultoi në dukje (përgjigje në letër) fryma pozitive për bashkëpunim me komunitetin LGBTI, por realiteti dhe praktika janë në nivele minimale, për të mos thënë zero.

Rekomandime

Për herë të parë bëhet një analizë gjithëpërfshirëse, studimore dhe krahasimore e përfshirjes pozitive të komunitetit LGBTI nga qeverisja vendore.

- Niveli shumë i ulët i bashkive në procesin e konsultimeve publike, parashikimeve në buxhet dhe projekteve me fokus komunitetin LGBTI. Mungesa e zhvillimeve të tilla në bashkitë e vogla dhe ato të reja.
- Numër shumë i vogël i përfshirjes së personave të komunitetit LGBTI në marrëdhënie me bashkitë, qofshin këto dhe formale.
- Raporti Bashki të vogla dhe Bashki të mëdha në favor të gjithëpërfshirjes së komunitetit LGBTI.
- Njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të zhvillojnë një politikë të mos-diskriminimit, e detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë nënpunësit apo të kontraktuarit e njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke ofruar shembullin pozitiv për të gjithë komunitetin e asaj njësie.
- Njësitë e vetëqeverisjes vendore rekomandohen të kenë përfaqësues ose anëtarë të komunitetit LGBTI, në çdo rast që do të merren vendime që i përfshijnë ato, akte ligjore apo politika të ndryshme, si dhe një mbështetje publike e lëvizjes së komunitetit LGBTI;
- Ngritja e një sistemi ankesash, me përfaqëuese të përbashkët Avokat i Popullit dhe shoqëri civile pranë njësisë të vetëqeverisjes vendore për trajtimin e ankesave për mosdhënie apo refuzim shërbimi përkundrejt qytetarëve, përfshi edhe personat LGBTI, apo ndërmjetësimin në konflikte minimale do të ndihmonte njësitë e vetëqeverisjes vendore në përmbushjen e funksioneve të tyre.
- Qeverisja qendrore të monitorojë zbatimin e objektivave të "Planit Kombëtar të Veprimit (PKV) për personat LGBTI 2016-2020" mbi mosdiskriminimin duke siguruar bashkërendim dhe burime të mjaftueshme të aktiviteteve të lidhura, llogaridhënien për autorët dhe shpërblimin e viktimave.

-
- Mbështetja e fushatave të edukimit publik për të kundërshtuar qëndrimet homofobike dhe transfobike dhe adresimin e portretizimeve negative dhe stereotipike të personave LGBTI në media, duke zgjeruar funksionet e AMA (Ligji për AMA);
 - Organizatat e shoqërisë civile duhet të zhvillojnë aftësitë në fushën e udhëheqjes dhe qeverisjes; si dhe të rrisin qeverisjen aktuale duke rritur pjesëmarrjen e grupeve të synuara në vendimmarrje;
 - Organizatat e shoqërisë civile rekomandohet të përmirësojnë aftësitë në komunikim dhe fushata publike;
 - Përmirësimi i kapaciteteve për të dokumentuar dhe monitoruar shkeljet e të drejtave të njeriut; si të mësojnë rreth procesit gjyqësor strategjik për të provokuar reagimet institucionale dhe ligjore;¹⁷

Së përfundim mund të themi që një bashkëpunim më i madh dhe i hapur ndërmjet organizatave të shoqërisë civile, që mbrojnë dhe mbështesin komunitetin LGBTI, qeverisjes vendore dhe qeverisjes qendrore do të sjellë gjithëpërfshirje më të madhe, ofrim të shërbimeve pa diskriminim dhe dëgjim të zërit të të gjithë qytetareve, në funksion të mirëqeverisjes.

Bibliografia

- Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"
- Ligji 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik"
- Parlamenti I Shqipërisë – Bashkitë, Koordinatorët për të Drejtën e Informimit.
- "Plani Kombëtar i Veprimt (PKV) për personat LGBTI 2016-2020"

http://www.sociale.gov.al/files/documents_files/PKV_LGBTI_2016-2020.pdf

- "NDI Poll për Çështjet LGBTI në Ballkan" 2015, NDI Poll on LGBTI Issues in the Balkans"2015 NDI, USAID, Civil Rights Defenders, Gay & Lesbian Victory Institute. 2015. – (Case of Albania.) www.ndi.org/LGBTI_Balkans_poll
- Raportit të hartuar nga Streha 2015-2016, Streha's annual report 2015-2016, http://strehaLGBTI.al/en_US/
- Poni & Hazizaj (2016a) Community Services and the LGBT people community in Albania: *Public administration attitudes on LGBT people as service users, in 6 regions*. Tirana: Pink Embassy Publications, accessed 4.9.2016,

¹⁷ BEING LGBTI IN EASTERN EUROPE: Reducing Inequalities & Exclusion, and Combating Homophobia & Transphobia experienced by LGBTI People. Findings and recommendations of the Country Report. Ms.MeritaPoni, Author of the National Report "Being LGBTI in Albania", UNDP 2017.

<http://www.pinkembassy.al/sites/default/files/uploade/SHE%CC%88RBIMET%20VENDORE%20DHE%20KOMUNITETI%20LGBT%20NE%20SHQIPERI%202016.pdf>

- BEING LGBTI IN EASTERN EUROPE: Reducing Inequalities & Exclusion, and Combating Homophobia & Transphobia experienced by LGBTI People. Findings and recommendations of the Country Report. *Ms. Merita Poni*, Author of the National Report “Being LGBTI in Albania”, UNDP 2017.
- OKB -
http://www.undp.org/content/dam/undp/library/Poverty%20Reduction/Inclusive%20development/Towards%20Human%20Resilience/Towards_SustainingMDGProgress_Ch8.pdf
- Këshilli i Europës, nga parimet e mirëqeverisjes.

[https://www.coe.int/en/web/good-governance/12-principles-and-elope#{"25565951":10}](https://www.coe.int/en/web/good-governance/12-principles-and-elope#{)

- UNESCAP

<http://www.unescap.org/resources/what-good-governance>

- Raport me dokumentim rastesh dhe përshkrim të situatës për 2016, Aleanca kundër Diskriminimit LGBT.
- Raport nga grupi i familjeve të personave LGBTI “JAM Fëmija YT!”, Open Mind Spectrum Albania (OMSA).